



REPUBLIKA E SHQIPËNISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 11 Prot

Tiranë, më 16.04.2007

VENDIM Nr. 2 dt. 03.04.2007

Në mbështetje të nenit 17, të ligjit nr. 9592, datë 27.07.2006, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, dt 07.04.2003 "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 03.04.2007, pasi shqyrtoi të gjitha pikat e rendit të ditës

VENDOSI:

1. Të rishqyrtohet rregullorja "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar të Restaurimeve", nga Sektori Juridik i Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
2. Në mungesë të Kartës Shqiptare të Restaurimit, materiali i përgatitur për zbatimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në restaurim, do të shërbejë si një udhëzim për punimet në restaurim.
3. Të merren masa për zhvendosjen e arkivit të IMK, pranë ambienteve të kërkuara, në mënyrë që të mos pengohet më tej hartimi i projekteve të investimeve për vitin 2007.
4. Të bashkëpunohet me instancat përkatëse, për të realizuar në mënyrë sa më të shpejtë shmangien e dëmtimeve, që kanë krijuar ndërtimet e paligjshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PROF. DR. YLLI PANGO

KRYETAR

SEKRETAR I K.K.R.

PROF. DR. APOLLON BAÇE